



Datë/a:	06.08.2018
Për/ Za/ To:	SWISMED SHPK
CC:	Departamenti i Prokurimit
Nga/ Od/ From:	Zekë Bardhaj – Udhëheqës i Departamentit të Prokurimit – Komuna e Prishtinës
Tema/ Subjekat/Subject:	Vendim për Rishqyrtim të Kërkesës

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 03.08.2018 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "SWISMED", lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "**Furnizimi me material shpenzues për shërbime laboratorike dhe RO-Kabineti**", me Nr. të Prok: **616 18 3707- 121** nxjerr:

V E N D I M

- I. **HEDHET POSHTË**, si e pa afatëshme ankesa e OE ankues "SWISMED", e datës: 03.08.2018, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "**Furnizimi me material shpenzues për shërbime laboratorike dhe RO-Kabineti**", me Nr. të Prok: **616 18 3707- 121**", pasi që e njëjta është parashtruar jashtë afatit ligjor për rishqyrtim në Autoritetin Kontraktues.
- II. Ankesa e operatorit ekonomik ankues nuk mund të shqyrtohet, pasi që e njëjta është parashtruar jashtë afatit ligjor.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A R S Y E T I M

Operatori Ekonomik: "SWISMED" ka bërë kërkesë për ri-shqyrtim me datë 03.08.2018.

Autoriteti Kontraktues me datë 24.07.2018 ka dërguar letren standarde për eliminim.

Baza Ligjore për refuzim të Kërkesës për Ri-shqyrtim

Ligji i Prokurimit Publik në bazë të nenit 108/A – Zgjidhja e mosmarrëveshjeve , par 3. i cili thekson:

"3. Kërkesa për shqyrtim duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues, me postë ose me çdo mjet tjetër të komunikimit të lejuar me këtë ligj, brenda afateve të mëposhtme:

3.2 në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit, brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së njoftimit për dhënien e kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit që i është dërguar ankuesit.

Operatori Ekonomik ankimor ka pranuar letrën standarde për tender te eliminuar me datë **24.07.2018**.

Vendimi për dhenie të kontratës është dërguar për publikim me datë ndërsa është publikuar me datë 02.08.2018

Duke u bazuar në dispozitat e nenit 108/a par.3 dhe 3.2. OE ankimor ka lëshuar afatin ligjor (ius strictum) për të parashtruar ankesë pasi që në ditën e dhjetë(10) ka parashtruar ankesë të precizuar pra me datë **03.08.2018** edhe pse afati ka pasur vetëm deri me datë **30.07.2018**.

Rregullat dhe Udhezuesi Operativ për Rregullat e Prokurimit Publik në nenin 22 par.3 thekson:

Nëse njoftimi dërgohet në ditën e premte (.06.2018), afati kohor për parashtrim të ankesës fillon ditën e premte sepse:

- ✓ **Dita e premte është dite pune**
- ✓ Ne përputhje me Nenin 4, paragrafi 4.2 të Rregullave për parashtrim të ankesave, data e njoftimit është **“dita 0” e 5 ditëve**

Do të thotë:

- a. nëse Autoriteti Kontraktues arrin që të njoftoj zyrtarisht OE ditën e premte afati kohor për parashtrim të ankesës fillon ditën e premte (**dita 0 e 5 ditëve**), ndërsa
- b. nëse Autoriteti Kontraktues NUK arrin që të njoftoj zyrtarisht OE ditën e premte afati kohor për parashtrim të ankesës fillon ditën e hënë.

Në përputhje me nenin 4, par.4.2. të Rregullave për parashtrim të ankesave, data e publikimit duhet të jetë e njëjtë me datën kur AK e njofton OE dhe në rast të mospërputhjes së datave, mbizotëron data kur njoftimi me shkrim i dërgohet Operatorit Ekonomik.

Në këtë rast OE ankimor prapë ka humbur afatin ligjor për parashtrim të kërkesës për ri-shqyrtim pasi që letrën standarde për tenderuesin e eliminuar e ka marrë me datë 24.07.2018, ndërsa kërkesa për ri-shqyrtim është parashtruar me datë 03.08.2018 që dë të thotë është humbur afati ligjor (ius strictum).

Si dhe neni 108/a i LPP-se paragrafi 8.1 përcakton se “Autoriteti kontraktues do ta refuzojë një kërkesë për rishqyrtim kur: 8.1 kërkesa nuk dorëzohet brenda afateve kohore të përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni;

ZPP, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Sqarim:”Edhe përkundër fakteve të lartëcekura lidhur me parashtrimin e kërkesës me vonesë ju sqarojmë se autorizimi nga prodhuesit nuk ka qenë kërkesë e FDT-së dhe nuk do të kishim bazë për aprovimin e kërkesës tuaj.

Këshillë Juridike :

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së.

Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.